



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 28.3.2013, e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Prof. dr. Isa Mustafa, kryetar i Komunës, dr. Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit të Komunës, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Hetem Kupina, Avdush Dobratiqi, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Valon Hiseni, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Fetah Salihu, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Shemsi Veseli, Skënder Reçica, Besa Halimi – Zagragja, Lumnie Rama, Shefqet Sylejmani, Astrit Hasani, Meliza Haradinaj, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Kimet Zeqa, Feti Mejdiu, Sadri Ramabaja, Afërdita Veliu dhe Engin Beyoglu.

Munguan: Bekim Gashi, Ismail Kasumi, Musli Mehaj dhe Liridon Restelica.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE – së, të INPO-së dhe të mjeteve të informimit.

Mbledhjen e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues i Kuvendit, dhe njëherësh hapi diskutimin rreth rendit të ditë.

U konstatua se njëzëri u miratua ky

R E N D I T E:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë;
2. Raporti i punës për vitin 2012 i NPK “Ndërmarrja Banesore”;
3. Raporti i punës për vitin 2012 i NPK “Termokos”;
4. Raporti i punës për vitin 2012 i NPK “Sport Marketing”;
5. Raporti i punës për vitin 2012 i NPK “Stacioni i Autobusëve”;
6. Propozimrregullorja për transportin rrugor në territorin e komunës së Prishtinës;
7. Propozimrregullorja për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Prishtinës;
8. Pyetje dhe përgjigje;
9. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë.

Naim Makolli bëri vërejtje në ekstrakt, në pikën e dytë, duke shtuar se unë kam pyetur: Pse nuk ka hyrë në raport rruga e Mramorit, për te shtëpia e Shefki Gashit? Pra, nuk ka qenë fjala për rrugën e asfaltuar në Marec.

Vërejtje tjetër ka të bëjë me ndërtimin e shkollave, ku kam thënë se po mbesin shkollat e zbrazëta, sepse po ndërtojmë shkolla ku nuk ka nxënës.

Besa Halimi-Zagragja tha se kam një vërejtje, më tepër parimore, lidhur me ekstraktin. Ekstrakti duhet të përmbajë thelbin e diskutimeve të asamblistëve, por jo edhe përgjigjet e drejtorëve të drejtorive komunale, ose edhe të kryesuesit. Nëse ekstrakti përmban gjithçka nga pak prej asaj që flitet dhe kërkohet miratimi i ynë, atëherë do të duhej të përmbante edhe përgjigjet përkatëse lidhur me diskutimet dhe pyetjet që shtrohen.

Shefqet Sylejmani tha se në pikën e dytë është lëshuar një gabim teknik, e që duhet të jetë: "Duhet të bëhet më shumë në reformimin e mëtejme të administratës".

U konstatua se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë.

Pika e dytë

Lidhur me Raportin e punës për vitin 2012 të NPK "Ndërmarrja Banesore"

Kryesuesi hapi diskutimin.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së dhe në emër të Komisionit komunal të aksionarëve të NPK "Ndërmarrja Banesore", paraqiti raportin e punës të kësaj ndërmarrjeje, duke shtuar se kjo ndërmarrje veprimtarinë e vet e ushtron në pajtim me dispozitat ligjore, përfshirë edhe dispozitat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe Statutin e ndërmarrjes.

Nga të dhënat e paraqitura, shihet se ndërmarrja, përkundër sfidave dhe vështirësive, objektive e subjektive, të trashëguara, të grumbulluara nga vitet e pasluftës, ka ngritje të konsiderueshme të performancës. Përveç angazhimit të shtuar të të gjithë të punësuarve, stafit të sektorëve, Bordit të drejtorëve, është i pa kontestueshëm edhe përkushtimi, kontributi dhe performanca e lartë e kryeshefit ekzekutiv të ndërmarrjes në angazhim dhe ushtrim të detyrimeve dhe kompetencave ligjore statutare. Problemi i borxheve të shfrytëzuesve dhe konsumatorëve të shërbimeve të kësaj ndërmarrjeje dhe arkëtimi i tyre, është prezent, veçmas nga borxhet shumëvjeçare të akumuluar, i situatës së paqartë dhe konfuzitetit të shfrytëzuesve të pronave dhe të banorëve uzurpatorë etj.

Pasqyrimi financiar është i përgatitur sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, dhe raportimi është bërë sipas standardeve ndërkombëtare për raportin financiar. Neto pasuritë jo qarkulluese të Ndërmarrjes Banesore janë 6.702.386 euro, ndërsa pasuritë qarkulluese pas provizionimit janë 3,611.665 euro. Gjatë kësaj periudhe raportuese, prona, kapitali dhe asetet e ndërmarrjes janë ruajtur dhe janë trajtuar në pajtim me ligjin. Kapitali i ndërmarrjes është korrigjuar, është zvogëluar pas provizionit të llogarive të arkëtuara për periudhën 1999 - 2001, në vlerë prej 3.427.970 eurosh. Të dhënat tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë e kësaj ndërmarrjeje, janë të pasqyruara në këtë raport.

Për të gjitha vështirësitë dhe pengesat në mbarëvajtjen e punëve të kësaj ndërmarrjeje, konsiderojmë se ligji aktual lë hapësirë për konfuzitet në raportet mes Komisionit të aksionarëve dhe Bordi të drejtorëve, pastaj Bordi i drejtorëve dhe kryeshef i ekzekutivit etj. Konsideroj se është e nevojshme që në këtë drejtim të bëhen korrigjime në ligj, ose ndonjë marrëveshje e veçantë, që të përmirësohen këto raporte, por edhe nga fakti se pa stimulim adekuat, përherë do të mungojë angazhimi i duhur dhe i nevojshëm i aksionarëve në NPK.

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, tha se, meqë jam edhe aksionar në këtë ndërmarrje, e kemi diskutuar këtë raport dhe e përkrahim për miratim.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, shprehu shpresën se në të ardhmen në hartimin e këtyre raporteve, do të ketë ndryshim në qasje ndaj aksionarëve, por edhe ndryshim prej aksionarëve për raportet ndaj këtyre ndërmarrjeve. E pranojmë si raport vjetor, me kërkesën që raportet e ardhshme të jenë pak më ndryshe.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, tha se edhe ne e kemi analizuar këtë raport. Mendojmë se këto raporte janë të punuara nga kryeshefat, e jo nga anëtarët e komisioneve të aksionarëve, dhe janë nënshkruar nga anëtarët e komisioneve. Raporti fillimisht duhet ta ketë një adresë, unë nuk po shoh adresë, dihet komisioni i aksionarëve, por duhet drejtuar Kuvendit komunal të Prishtinës. Në anën tjetër, përveç nënshkrimit, raporti në fillim është dashur të përmbajë përshkrimin, organizimin, synimet e ndërmarrjes publike, gjendjen rreth përgjegjësi, kompetencat, realizimin e buxhetit, mos realizimin e buxhetit, harmonizimin me aktet ligjore të Kosovës, sepse kemi diskrepancë jashtëzakonisht të madhe.

Komisioni komunal i aksionarëve, është dashur të përgatis, të nxjerrë politikën e pronësisë, përshkrimin e gjendjes sipas radhës nëpër departamentet, sepse do të obligohen për performancë. Në asnjë raport deri më tani nuk e kemi parë nëse është bërë ndryshimi i përbërjes së kryeshefit ose drejtorëve, se a janë ndërruar ata, a janë shkarkuar, se nuk kanë pasur performancë të mirë, apo për shkak se ka ardhur obligimi ligjor.

Raporti është dashur t'i ketë pengesat, cilat kanë qenë pengesat, pse nuk kanë mundur të realizohen, cilat janë sfidat, pra cilat janë rekomandimet që janë dhënë për vitin 2013, që aksionarët t'i tejkalojnë ato kriza, gjegjësisht ato objektiva që nuk kanë mundur t'i realizojnë.

Sa i përket NPK "Ndërmarrjes Banësore", dallon pak nga disa raporte tjera, se është dhënë më i detajuar në raport me disa NP, dhe vërehen disa lëvizje pozitive, që është për tu përshëndetur.

Duhet menduar që në të ardhmen të bëhet një zgjidhje në aspektin e kompensimit të anëtarëve të Komisionit të aksionarëve, për arsye se është e pajustificueshme që në vend se të shkojmë drejtë progresit, po shkojmë në regres.

Mejreme Berisha tha se edhe ne si GP, në parim e përkrahim këtë raport për miratim.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, me diskutimin e tij u ndërlihd rreth uzurpimeve që ka në këtë ndërmarrje, duke cekur se edhe Kuvendi, edhe organet tjera kompetente dhe të gjithë të tjerët, duhet ta kemi një regjistër konkret se kush

ka uzurpuar, cilin lokal, sa m², a paguan, sa nuk ka paguar, qofshin ata punëtorët e ndërmarrjes që kanë nga 2-3 lokale, qofshin njerëzit tjerë, struktura politike apo të biznesit apo grupe të ndryshme të interesit, sepse neve na vjen çdoherë e njëjta, se ka uzurpime. Kërkoj që çdo uzurpator të dihet me emër e mbiemër, paguan ose nuk paguan qira.

Feti Mehdiu në emër të Partisë së Drejtësisë, tha se ne e përkrahim miratimin e këtij raporti kështu siç është. Veçanërisht, e kemi pasur edhe ne mendimin që auditimi të jetë më në nivel. Ajo që më bëri përshtypje nga prezantimi i kryesuesit, ishte se këtë vit nuk ka pasur uzurpime. Më vjen mirë për një punë të tillë, mirëpo kjo kërkon një analizë pastaj, pse këtë vit nuk ka pasur. Ndoshta arsyeja është se janë plotësuar disa nevoja të qytetarëve, ose mos është vetëdijesimi i qytetarëve, por gjithsesi mbetet ajo, që e kërkuan edhe kolegët para meje, që lista duhet të jetë konkrete. Këtë vit nuk ka pasur, është mirë me e pasur një pasqyrë për të gjithë ata që kanë uzurpuar deri tash. E përkrahim këtë raport për votim, kështu siç është.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) tha se sipas konstatimit që kemi ne, bordet e ndërmarrjeve publike janë shndërruar në mekanizma politike, borde politike, nuk bënë përjashtim as ky i Ndërmarrjes Banesore. Nëse shikojmë me vëmendje, atëherë shihet se ato borde praktikisht nuk bëjnë kurrfarë pune dhe shndërrohen në makina votuese. Për fat të keq, punëtorët pikërisht këto borde i akuzojnë më së shumti. Ne e kemi parasysh letrën e punëtorëve të Trafikut Urban, të bërë tashmë publike. Insistimi që të paguhen komisionet, flet thjeshtë për interesa personale të anëtarëve të komisioneve. Ky raport i është dorëzuar një pjese të punëtorëve të ndërmarrjes dhe ata nuk e pranojnë si real, një pjesë e tyre kanë shumë vërejtje. Duke filluar prej pjesës hyrëse, ndërmarrja, potencohet në raportin e këtij viti 2013, aktualisht ka 78 punonjës. Në këtë pasqyrë nuk kemi faktin se sa janë pranuar sivjet, a është respektuar institucioni i konkursit?! Informatat tona flasin se janë pranuar edhe njerëz pa konkurs, madje familjarë të udhëheqjes politike, se në këtë ndërmarrje ka keqpërdorime jashtëzakonisht të mëdha financiare, dhe ne jemi të bindur që shumë shpejtë, vetë punëtorët, të cilët vuajnë më së shumti këtë, do të dalin publikisht me të dhëna bukur konkrete se sa është dëmtuar kjo ndërmarrje financiarisht dhe, përmes këtij dëmtimi, sa është dëmtuar edhe Komuna, përgjithësisht ekonomia e qytetit.

Fatkeqësisht, në vend se këto ndërmarrje të shndërroheshin në ndërmarrje dobiprurëse, fitimprurëse ekonomike, rentabile, ne jemi dëshmitarë se po ndodh e kundërta.

Luan Jusufi tha se raporti është përpiluar sipas njërive organizative, në kuadër të strukturës organizative të ndërmarrjes, në të cilën na paraqitet puna e secilës njësi gjatë vitit të kaluar. Pasqyrat financiare, janë të përpiluara sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit. Nga bilanci i gjendjes, vlen për tu përsëritur fakti se ndërmarrja gjatë vitit 2012, ka arritur që të zvogëlojë dukshëm kërkesat e saj, pra llogaritë e arkëtuara, të cilat gjatë vitit 2011 ishin në vlerë prej 5.343.000 euro, ndërsa në vitin 2012 janë zvogëluar, dhe tani janë në vlerë prej 1.890.000 euro. Gjithashtu vlen për tu përsëritur fakti se është ndërmarrja e parë komunale, e cila në llogarinë e saj dhe në arkën e saj, e ka përfunduar vitin 2012 me 6.180.863 euro, që është një vlerë shumë më e madhe sesa gjendja e llogarisë në bankë dhe në arkën e ndërmarrjes në vitin paraprakë, pra në vitin 2011. Edhe pse, siç shihet nga pasqyra e të ardhurave, kjo ndërmarrje gjatë vitit 2012, në krahasim me vitin 2011, ka pasur më pakë të hyra operative, gjithashtu shihet në përfundim se bilanci i pasqyrës së të ardhurave, se fitimi në këtë ka qenë dukshëm më i madh sesa fitimi në vitin e kaluar.

U miratua Raporti i punës për vitin 2012 i NPK "Ndërmarrja Banesore", me tri vota kundër (Sadri Ramabaja, Naim Makolli dhe Afërdita Veliu).

Pika e tretë

Për Raportin e punës për vitin 2012 të NPK "Termokos", kryesuesi hapi diskutimin

Tefik Mehmeti fillimisht tha se ne jemi komision i aksionarëve, dhe nuk kemi aq shumë qasje të hyjmë nëpër ndërmarrje, për të krijuar raporte aq të detajuara. Si komision e kemi bërë një raport të shkurtër, të cilin e kemi nxjerrë prej raportit të Bordit të drejtorëve që na është ofruar. Në faqen e parë janë të përshkruara veprimtaria, organizimi, statuti i ndërmarrjes, ndërsa në faqen e dytë është një përmbledhje e përgjithshme që është zhvilluar në vitin që po raportojmë.

Pra, këtë raport e kemi filluar me komisionin se çka ka marrë parasysh, që është shumë e rëndësishme, prona, asetet e ndërmarrjes janë trajtuar edhe në bazë të ligjit, dhe nuk ka ndërrim në asete dhe pronë të ndërmarrjes. Për kryeshefin ekzekutiv, e kemi potencuar se ka një performancë të shkëlqyer. Pastaj kemi paraqitur të dhënat me shkrim dhe në mënyrë tabelore të gjendjes, duke e krahasuar atë me vitin paraprak, që shihet se ka një rritje të përgjithshme në faturim, arkëtim, kjo nënkupton që ka pasur nxehje më shumë se sa në vitin 2011. Në faqen e tretë, gjithashtu i kemi dhënë dy tabela, duke e krahasuar vitin 2012 me vitin 2011, muaj për muaj, se çfarë energjie termike është prodhuar. Në faqen e katërt, gjithashtu i kemi bërë ca krahasime me vitin paraprak 2011, tek ulja e disa shpenzimeve, që besoj se është një meritë, apo është një qasje e mirë e Bordit dhe e kryeshefit. E arritur tjetër, e cila gjithashtu është cekur, është rregullimi apo barazimi që ka bërë "Termokosi" me ATK-në, për një borxh të viteve 2002-2004.

Projektin e kogjenerimit e kemi përshkruar në pika më të gjëra, për shkak se kemi menduar që është në interes të asamblesë dhe qytetarëve të Prishtinës, që të kenë informata më të shumta se në çfarë drejtimi është duke shkuar ky projekt.

Problem kryesor i Termokosit është arkëtimi shumë i ultë, që sillet diku rreth 30%.

Problem tjetër që e has Termokosi rregullisht, është çmimi i m². Gjithë periudha e pasluftës në Termokos ka qenë e udhëhequr keq, ku pasojat e asaj periudhe po i bart ky bord i drejtorëve. Megjithatë, ky bord dhe ky kryeshef, kanë menaxhuar ndërmarrjen në mënyrën më të mirë, me mundësitë që kanë pasur, dhe nga ana e komisionit kanë performancë shumë të mirë.

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, tha se është për t'u falënderuar

Zyra ligjore që na e ka ofruar një model për hartimin e raporteve të ndërmarrjeve, e që do ta kemi në dispozicion në të ardhmen. Sa i përket raportit të ndërmarrjes "Termokos", aksionari, z. Mehmeti, i tha të gjitha ato që vërtetë ka operuar dhe operon me vështirësi shumë të mëdha, i tha të gjitha arsyet. Unë e përgëzoj komisionin, por e përgëzoj edhe punën e kryeshefit, së bashku me Bordin. Natyrisht se nuk ka qenë e lehtë, dhe nuk është e lehtë për të menaxhuar me të gjitha ato probleme dhe obligime që i kanë trashëguar, mirëpo ky vit që po e lëmë pas, në masë të madhe ka qenë më i suksesshëm për ndërmarrjen. Prandaj GP i LDK-së e përkrah këtë raport.

Milazim Vitia, në emër të GP të AKR-së, tha se e përkrahim këtë raport të punës për vitin 2012 të ndërmarrjes "Termokos". Kjo ndërmarrje është pak sa më specifike, dhe e dimë se është ballafaquar me probleme të ndryshme, ballafaqohet edhe tani, dhe nëse nuk realizohet sa më shpejtë sistemi i ri i kogjenerimit, do të ketë probleme edhe në të

ardhmen. Nëse ky projekt realizohet më herët, atëherë besoj se problemet që kanë të bëjnë me nxehjen dhe Termokosin, do të jenë më të vogla, por do të jenë edhe çmimet më të arsyeshme dhe më të lira.

Shemsi Veseli, në emër të GP i PDK-së, u shpreh se nëse flitet se këto raporte janë të mira, unë them se nuk janë. Së pari, po e pyes kolegun, Tefikun, në cilën datë e ka paraqitur kryeshefi i Termokosit raportin, sepse nuk iu ka përmbajtur afatit ligjor. Nëse flasim për faturimin, unë nuk jam i prirë për ta sulmuar qytetarin e Prishtinës pse nuk po arkëtohet aq shumë. Një pjesë të fajit për këtë e ka pikërisht menaxhmenti, sepse nuk e bën korrigjimin e kohës dhe orarit se sa kohë e ka ofruar ngrohje, sa ka qenë efektive. Të flasim për rrjedhjen e ujit, e kam studiuar, deri diku edhe raportet e ndërmarrjeve tjera, plani aksionar ka qenë përpara i detajuar prej 4 inxhinierëve, i cili faktikisht nuk është zbatuar. Nganjëherë ka pasur mazut, por ka pasur rrjedhje të ujit dhe nuk janë përmirësuar ata gypa. Nëse flasim tash se a ka qenë çështja e prokurimit për ata gypa, unë po e them që ka pasur gypa brenda, për arsye se qysh në shtator të vitit 2010, kanë ardhur gypat, deri ë 15 tetor kanë qenë diku 7 km gypa që janë ndërruar. Është mirë ta themi për opinionin, pikërisht menaxhmenti që e ka hequr, gjegjësisht operatorin ekonomik, i ka kushtuar dhe faktikisht është gjobitur organi i shqyrtimit të prokurimit. Unë mendoj që në kuadër të këtyre raporteve mungojnë shumë gjëra, ku njëri prej lëshimeve që është bërë është mosparaqitja e raporteve për përmbushjen e nevojave të klientëve, nuk është bërë anketim që të merret mendimi i qytetarëve se sa janë të kënaqur në kuadër të këtyre raporteve, cilat janë shërbimet, cilësia, ku është defekti dhe cilat janë mundësitë alternative. Çdo komision komunal i aksionarëve i përgjigjet Kuvendit të Komunës, mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësisë, të cilat janë dhënë në këtë ligj. Komisioni komunal i aksionarëve në bazë vjetore, do t'i raportojë Kuvendit të Komunës mbi performancën e këtyre kompetencave, përgjegjësitë dhe arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, tha se i shqyrtuam të gjitha raportet e NPK-ve, në këtë drejtim edhe këtë të Termokosit. Shihet se është një performancë pozitive e nivelit të ngritur nga vitet e kaluara, është e pranueshme në tërësi, me një kërkesë që të dihet edhe numri i të punësuarve në këtë ndërmarrje. Aksionarët në ndërmarrje janë gati më shumë si mysafir, apo reprezentues në njëfarë mënyre, e jo edhe njerëz që mund të hyjnë në të gjitha ato thellësitë. Kjo ishte njëra prej kërkesave, që duhet të bëhen ndryshime në ligj, ose me ndonjë ujdj apo marrëveshje në mes të asociacioneve, gjegjësisht institucioneve të caktuara. Aksionarët janë ata që duhet të jenë, në realitet atë rol nuk e luajnë, por edhe ata që janë aksionarë e dinë këtë çështje.

Besa Rafuna, në emër të GP të LDD-së, tha se i kemi shqyrtuar të gjitha raportet e NPK-ve. Sa i përket këtij raporti të ndërmarrjes "Termokos", e dimë se ka shumë telashe ndërmarrja dhe ballafaqohet me probleme të mëdha, por me realizimin e projektit kapital projekti i kogjenerimit, shpresojmë shumë se do të tejkalohen në masë të madhe problemet dhe vështirësitë që i ka kjo NPK.

Feti Mehdiu, në emër të GP Partisë së Drejtësisë, tha se edhe ne e përkrahim këtë raport.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se nga ardhja e drejtorit të ri atje gjithsesi ka përmirësime në menaxhimin e ndërmarrjes, sidomos në raport me punëtorët, sepse, siç e dimë, 7 paga më herët kanë qenë të mbetura prapa dhe, në ndërkohë, janë shlyer këto obligime ndaj punëtorëve. Janë shlyer edhe një pjesë e mirë e borxheve që i ka trashëguar ndërmarrja. Këto janë informacionet tona që i kemi për këtë ndërmarrje. Megjithatë, na lejoni që të përcjellim vërejtjet që duam t'i potencojmë, e që na vijnë kryesisht prej qytetarëve të zonave që furnizohen. Ata vlerësojnë se cilësia e ngrohjes nuk ka pasur përmirësim të ndjeshëm me vitet paraprake. Kapaciteti i ngrohjes ka qenë i ultë, dhe nuk ka mbuluar tërë ditën, por vetëm në mëngjes dhe në mbrëmje, edhe pse do duhej të ishte prej orës 6:00-23:00. Për fat të mirë, këto dy sezona po, për dallim prej vitit të kaluar, kur është menaxhuar nga zonja Pula. Për pasojë është faturuar 59% më shumë sesa që është ofruar. Sa i përket ngritjes së besueshmërisë nga qytetarët, nuk bazohet në asnjë të dhënë. Duhet të merret si bazë numri i ankesave nga qytetarët, nëse numri i tyre ka rënë, apo është ngritur, dhe në bazë të tyre mund të kuptohet ngritja, apo rënia e besueshmërisë. Nga fundi i janarit dhe fillimi i shkurtit, pothuajse nuk kemi fare ngrohje, thonë qytetarët, sidomos ata të lagjes "Dardania". Kjo vazhdon edhe sot për qytetarët e zonave të veçanta. Nga departamenti i financave i kësaj ndërmarrjeje, mungon një pasqyrë e të dhënave financiare. Sipas raportit, përkundrazi, na rezulton se ndërmarrja ka nevojë për mbështetje të vazhdueshme nga Komuna. Janë të njëjtat anëtarë të komisionit që kanë qenë në këtë ndërmarrje edhe gjatë kohës sa këtë ndërmarrje e ka drejtuar zonja Pula. Unë bëjë thirrje që në këtë drejtim, ky komision të japë përgjegjësi ose të shkarkohet. Pavarësisht vërejtjeve që i potencuam, raporti është më korrekt se ai i vitit të kaluar, evidenton shumë të meta, natyrisht që evidenton edhe vështirësitë që i ka ndërmarrja etj. etj. Me gjithë vërejtjet që i potencuam, këtë raport ne nuk do ta votojmë, do të abstenojmë.

Skender Reçica u përqendrua te dy çështje pak më specifike. E para, lidhur me shkallën e arkëtimit foli edhe kryesuesi, por edhe z. Mehmeti e veçoi se është shkalla e ultë e arkëtimit, ndërsa në raport thuhet diku 71% është realizuar, nëse kjo është e saktë. Unë nuk konsideroj që 71% është shkallë e ultë e arkëtimit, ndërsa nëse shikohet tabela, vërtetë del se nuk është shkalla e arkëtimit 71%, por është më e ultë. Nuk e di a është bërë ndonjë lëshim në hartim të raportit, apo ku është problemi.

E dyta, te shpenzimet e mazutit, e dimë të gjithë se çfarë është çmimi dhe si përcaktohet çmimi i mazutit, nga raporti shihet se është shpenzuar për këta 4 muaj diku rreth 4.584,15 ton mazut. Nuk e di me çfarë çmimi e kanë blerë, nuk e dimë saktë sa kanë shpenzuar në blerjen e mazutit, kur i kanë filluar procedurat e kuotimit etj.

Do të ishte mirë që kolegët tanë aksionarë të na i japin këto të dhëna, me qëllim që të dimë pak më saktë rreth shpenzimeve dhe shkallës së arkëtimit.

U miratua Raporti i punës për vitin 2012 i NPK "Termokos", me tri vota kundër (Shemsi Veseli, Lumnije Rama dhe Skënder Reçica) dhe dy abstenime (Sadri Ramabaja dhe Afërdita Veliu).

Pika e katërt

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me Raportin e punës për vitin 2012 të NPK “Sport Marketing”,

Bajram Selimaj, në emër të anëtarit të Komisionit të aksionarëve, i njoftoi të pranishmit për historikun e kësaj ndërmarrjeje, duke cekur se NPK “Sport Marketing” për herë të parë është regjistruar në vitin 1991, pas luftës ishte regjistruar nga UNMIK-u , ndërsa vitin e kaluar është regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, si ndërmarrje me 100% të aksioneve të Komunës së Prishtinës. Aktiviteti i saj është menaxhimi i pishinës së Gërmisë dhe i Shtëpisë së Gurit në Brezovicë. Puna dhe suksesi i saj është i kushtëzuar nga kushtet klimatike, kështu që shpeshherë i del në ndihmë Komuna. Komuna e ka marrë parasysh kërkesën, që të aktivizohet pishina e Gërmisë për patinazh gjatë sezonit dimëror. Komisioni i aksionarëve ka bërë përzgjedhjen e kandidatëve për Bord të ri të drejtorëve. Si Komision i aksionarëve e përkrahim këtë raport, sepse jemi të vetëdijshëm që kushtet e pafavorshme atmosferike e kanë sjellë në bilanc negativ këtë ndërmarrje.

Aziz Pacolli, GP i AKR-së, tha se kjo ndërmarrje veprimtarinë e saj e zhvillon vetëm në pishinën e Gërmisë dhe në Shtëpinë e Gurit në Brezovicë, të cilës vitin e kaluar iu ka rinovuar kulmi, por, me sa më kujtohet, tash një vit kemi diskutuar rreth një projekti, që ka të bëjë me zvogëlimin e nivelit të liqenit dhe ndërtimin e një terreni të patinazhit. Qysh vjet është thënë se në kohën kur do të lëshohet uji nga pishina, do të fillojë puna e rregullimit të liqenit të Gërmisë. Kisha pyetur se a do të kemi këtë vit sezon të shfrytëzueshëm në liqenin e Gërmisë, apo ndoshta pikërisht në atë periudhë do të fillojnë punët për zvogëlimin e lartësisë së liqenit.

Shemsi Veseli, GP i PDK-së, tha se veprimtaria e kësaj ndërmarrjeje varet shumë nga kushtet klimatike. Kam qenë dhe jam ithtar i asaj që NPK “Sport Marketingu” të ndihmohet më shumë me projekte dhe të subvencionohet nga Komuna. Asnjëherë nuk kam mundur të pajtohem me faktin se përballë pishinës është parkingu, ku shkojnë qytetarët të lahen, e atë parking e shfrytëzon NPK “Hortikultura”. NPK “Hortikultura” mjaftë po subvencionohet nga Komuna, andaj duhet ta shikojmë mundësinë që Sport Marketingu të mbështetet më fuqishëm në këtë aspekt, sidomos kur e kemi parasysh edhe specifikën tjetër, se edhe te Shtëpia e Gurit gjithnjë po kufizohet, për shkak se në Brezovicë po ka probleme nga komuniteti serb, udhëheqja dhe menaxhimi paralel i atyre objekteve. Jam përkrahës i asaj që NPK “Sport Marketingu” të veçohet pak, sepse edhe qytetarët e komunës së Prishtinës kanë nevojë për rekreacion.

Shefqet Sylejmani, GP i AAK-së, shprehu keqardhje për këtë afarizëm negativ të NPK “Sport Marketingut”, megjithatë i kuptojmë të gjitha vështirësitë, e në veçanti ato klimatike për vitin e kaluar afarist të ndërmarrjes. Urojmë që të tejkalohen këto vështirësi, me një kërkesë që Kuvendi i Komunës së Prishtinës është e nevojshme që të ndërhyjë nga mjetet për subvencion kësaj ndërmarrjeje, në mënyrë që të tejkalohet një gjendje bukur e rëndë financiare, ngase është krijuar nga arsyet e shënuara në raport. Mendoj që duhet të veprohet në kuptimin e rregullimit të pishinës së Gërmisë. Është kërkesë e kahershme dhe nuk e besoj se do të ishte mirë që edhe ky sezon ta gjej në këtë gjendje pishinën. Ne e përkrahim këtë raport.

Besa Rafuna, GP i LDD-së, tha se e kemi shqyrtuar edhe këtë raport dhe na shprehim keqardhje për afarizmin negativ që ka treguar. Pajtohem me parafolësit që kjo

ndërmarrje ka nevojë imediate për ndihmë të vazhdueshme financiare, siç është kërkuar edhe në rekomandimet e aksionarëve. Pra, pajtohemi që të ndihmohet, që projektet e planifikuara për vitin 2013, ose edhe për vitin tjetër, të zbatohen në praktikë, sepse është i vetmi vend për rekreacion.

Feti Mehdiu, GP i Partisë së Drejtësisë, përkrahu raportin. Ne mendojmë që krahas sportit dimëror me akull, teleferiku mund të jetë më i preferuar. Nuk e di sa mund të kushtojë, por le t'i kenë parasysh, cilat janë më racionale le ti përdorin.

Aferdita Veliu përkrahu parafolësit, duke thënë se edhe në këtë raport, ashtu si edhe raportet tjera, janë vërejtjet e njëjta. Megjithatë, ne e dimë që kushtet janë më specifike për mbarëvajtjen e punës së kësaj ndërmarrjeje, dhe ne do të donim që kjo ndërmarrje të prosperojë dhe t'i ndihmohet, sepse e gjithë kjo do të ishte në dobi të qytetarit. Ne mendojmë se në këtë raport mbetet shumë për t'u dëshiruar, andaj dhe ne abstenojmë.

Sadri Ramabaja tha se kur i bëmë vizitë Shtëpisë së Gurit në Brezovicë, që atëherë kam qenë në dakord që, në komunikim me Drejtorinë e Sportit të qytetit të Bazelit, t'i vë në kontakt për subvencion në këtë fushë. Asnjëherë, as drejtori i ndërmarrjes, as dikush nga Komuna, nuk më ka pyetur për mundësi të tilla dhe ajo mbështetje, për fat të keq, ka shkuar në Bullgari, çka do të thotë se ne shpeshherë jemi për, me fjalë të mira etj. etj. po nuk angazhohemi konkretisht. Po të funksiononte si duhet Zyra për bashkëpunim me jashtë, me diasporën tonë, me shtete tjera etj, sidomos ajo zyra që e kemi të obligueshëm të funksionojë, Zyra për integritet evropiane, sigurisht që kjo ndërmarrje, do të mbështetej jashtëzakonisht shumë dhe do t'i hynte në shërbim qytetarëve. Megjithatë, unë mbetem që ta mbështesim, jam në dispozicion, por jo vetëm pas një viti të na kujtohet.

Kryesuesi tha se është fatkeqësi nëse vjen një donacion dhe humbet, por po më vjen çudi që po merret dhe po interpretohet si çështje individuale, se mua nuk më ka thirrur dhe nuk më ka thënë askush. Në Komunë të Prishtinës ka zyrë, e cila pretë me ardhur një donator dhe me iu qasur problemit për ta bërë një zgjidhje.

U miratua Raporti i punës për vitin 2012 i NPK "Sport Marketing", me dy abstenime (Sadri Ramabaja dhe Aferdita Veliu).

Pika e pestë

Lidhur me Raportin e punës për vitin 2012 të NPK-së "Stacioni i Autobusëve"

Muhamet Nura tha se GP i LDK-së e ka shqyrtuar Raportin e grupit të aksionarëve të NPK "Stacioni i Autobusëve". Kjo ndërmarrje nga fundi i vitit 2012 ka kaluar në kompetencat e Komunës së Prishtinës. Veprimtaria e NLK "Stacioni i Autobusëve" daton prej vitit 1978, si veprimtari shërbyese për transportin e udhëtarëve në trafikun ndër-urban. Komisioni i aksionarëve të NPK "Stacioni i Autobusëve" i propozon Kuvendit të Komunës së Prishtinës këtë Raport, të hartuar në bazë të kompetencave ligjore për performancën e NPK-së "Stacioni i Autobusëve" SHA në Prishtinë, duke i përqendruar veçanërisht në objektivat për performancën operative, rezultatet e arritura, efikasitetin, cilësinë e shërbimit, performancën financiare, qarkullimin, efikasitetin e krijimit të të hyrave, të shpenzimeve të tyre, qeverisjen e përbashkët, monitorimin e Bordit, planifikimin e biznesit dhe perspektivën e ardhshme, investimet dhe rreziqet. Si aksionar në këtë ndërmarrje, kërkoj këtë raport ta përkrahni dhe të kaloni në procedura të mëtutjeshme.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se në raportin e kësaj ndërmarrje janë dhënë të dhënat se çka kanë mjete të veta, kështu që uroj sukses në punën e mëtutjeshme, me raporte më komplete në të ardhmen.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, tha se për hir të korrektësisë, nga ana e menaxhmentit, pavarësisht që statusi i kësaj ndërmarrjeje ka qenë i pa definuar, ka qenë dashur që këtij komisioni të aksionarëve t'i plasojnë disa të dhëna, në mënyrë që ta kemi një pasqyrë më reale të mundshme.

Megjithatë, ne do ta votojmë dhe më gëzon fakti që për një kohë jo shumë të gjatë, qenka zgjedhur Bordi i drejtorëve dhe tash uroj që të bëhet edhe një përzgjedhje e mirë edhe e kryeshefit për menaxhimin e ndërmarrjes.

Astrit Hasani, në emër të GP i AAK-së, tha se pajtohem me parafolësit, që duhet të jetë një pasqyrë më e veçantë, në mënyrë specifike transporti periferik ndër-urban, në mënyrë që të sigurohemi që transporti publik shkon në çdo lagje dhe në fshatra.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, tha se kjo ndërmarrje e ka një menaxhim që është profitabil, është pozitive në financa. Gjithashtu ata e kanë ruajtur atë pronësi atje deri diku, edhe pse ne nuk e dimë se si janë zhvilluar ato. Ky raport është pak më i gjerë dhe këto shënime që na janë ofruar në raport, mjaftojnë sa për t'u njoftuar se çka është ajo ndërmarrje. Me rastin e zgjedhjes së drejtorit ekzekutiv, mendoj se do të jetë një raport total i lidhur me zhvillimet që do të bëhen.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, uroi që Stacioni i Autobusëve të jetë sa më i suksesshëm. Mirë qenka që ka fitim, atë fitim besojmë që do ta administrojnë mirë dhe drejtë.

Njëzëri u miratua Raporti i punës për vitin 2012 i NPK "Stacioni i Autobusëve".

Pika e gjashtë

Lidhur me Propozimrregulloren për transportin rrugor në territorin e komunës së Prishtinës, Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, tha se në këtë rregullore janë bërë harmonizimet e dispozitave për transportin rrugor, që ka numrin 2004/01 dhe të Ligjit që ka numër 02L- 127, që ka të bëjë me ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji. Rregullorja përmban dispozitat e përgjithshme, dispozitat e veçanta, që kanë të bëjnë me ushtrimin e transportit të udhëtarëve, transportin e veçantë, transportin për nevoja personale, kushtet që duhet plotësuar automjeti në rastin e ushtrimit të tij, transporti, rendin e stacioneve dhe vend-ndaljen, transportin rrugor të mallrave, mbikëqyrjen, masën ndëshkuese, si dhe dispozitat kalimtare shfuqizuese dhe të hyrjes në fuqi.

Hetem Kupina, në emër të GP të LDK-së, tha se në bazë të analizave dhe vlerësimit të Grupit parlamentar, konsiderojmë se të gjitha kriteret që është dashur të parashihen në rregullore, janë të paraqitura në mënyrën më të mirë të mundshme. Ju bëjë thirrje që kjo rregullore të zbatohet në përpikëri nga kompetentët.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se në transportin rrugor, veçanërisht në trafikun urban, ka një kaos, i cili po ia prish edhe hijeshinë qytetit. Do të thotë nuk ka kurrfarë rregulloreje, ne mund të miratojmë Rregulloren, por nëse këto nuk

zbatohen në terren, atëherë do ta kemi një trafik urban çfarë e kemi. Këtu ceket se janë dhënë 50.000 € për donacion prej komunës për blerjen e autobusëve, janë blerë dy autobus, njëri bënë e tjetri ende nuk është në funksion. Unë kisha kërkuar që çdo donacion, apo çdo mjet që është dhënë, të raportohet në Asamble komunale sesa u shfrytëzuan dhe për çka u shfrytëzuan ato mjete.

Besa Halimi – Zagragja, në emër të GP të PDK-së, tha se në parim e përkrahim këtë rregullorja. Kemi një pyetje, sepse nuk e kemi parë në pikat apo nën-pikat e neneve të kësaj rregulloreje a përcaktohet diku distanca minimale e vendeve të autobusëve ose transportit publik urban.

Sa i përket letrës që është dërguar në adresën e të gjithë asamblistëve dhe të menaxhmentit të Komunës, unë besoj se një ndërgjegje e asamblistit dhe e qytetarit, pavarësisht që ajo është anonime, na obligon që të marrim një përgjegjësi, çoftë të ngritjes së një komisioni që do të dalë nga ky Kuvend, çoftë të shqyrtimit të të dhënave të saj në pikën “të ndryshme”, por dhe në rast se të dhënat e letrës nuk janë të vërteta, le të demantohen dhe le të dalin si një shqetësim i panevojshëm. Anashkalimi nuk do të na bënte nder as neve si asamblistë, por as Kuvendit dhe menaxhmentit.

Kryesuesi tha se është një letër që nuk ka shkuar as në Komision të aksionarëve, as nuk ka shkuar atje, por është shpërndarë nëpër portale dhe nëpër media dhe nuk është e nënshkruar nga askush. Kërkoj nga komisioni i aksionarëve që të shkojë në atë ndërmarrje, të bëjnë takim me menaxhmentin, me Bordin e drejtorëve, dhe le ta shqyrtojnë këtë çështje, por jo që ne jemi duke anashkaluar, sepse ne e kemi një komision tonin atje prej kolegëve tanë.

Mejreme Berisha, në emër të GP të AAK-së, tha se këtë rregullore e kemi shqyrtuar, por njëherësh pajtohemi edhe me parafolësit. Nuk vërejtja a ka ndonjë kategori të shoqërisë sonë që lirohet nga pagesa, se i pamë atje edhe tarifën, edhe ato si kategori shoqërore. E di se një rregullore që e kemi pasur në mandatin e mëhershëm, së paku personat me aftësi të kufizuara kanë qenë të liruar nga pagesa në transportin e trafikut urban.

Besa Rafuna, në emër të GP të LDD-së, tha se me dëshirë dhe shpresë që kjo Rregullore të zbatohet në praktikë, ne si Grup parlamentar i LDD-së, e përkrahim miratimin e Rregullores për transport rrugor në komunën e Prishtinës, e cila është e specifikuar deri në detaje.

Feti Mehdiu tha se edhe ne në parim e përkrahim Rregulloren, por kemi edhe disa sugjerime.

E para, na duket e pa saktë faqja tre, ku thuhet se: “lirohen disa automjete, ndihma e shpejtë, automjetet e zjarrfikësve etj”. Do të ishte më e saktë të jetë pas zjarrfikësve “dhe të ngjashme me këtë” për shkak se në “etj. ” mund të hyjnë shërbimet, të cilat nuk i ngjajnë as zjarrfikësve, as ndihmës së shpejtë.

Në nenet 17, 18 ose nenin 30, të inkorporohen disa sugjerime tona, që kanë të bëjnë me kategoritë e caktuara, siç janë pensionistët, studentët, qytetarët në asistencë sociale, që këto kategori të pajisen me kartela të udhëtimit.

Sadri Ramabaja tha se kjo rregullore teknikisht është hartuar shumë mirë, por në praktikë ne e shohim se qyteti-trafiku urban i qytetit, është skandaloz. Megjithatë, ne vëmendjen e kemi përqendruar më shumë te kjo letra publike, e cila nuk është anonime, por është publike. Këtu ishin disa të dhëna shqetësuese, që do të duhej të ishin objekt i prokurorisë.

Sipas kësaj që e lexova, ata e paskan njoftuar Kuvendin më herët për diçka të kësaj natyre. Unë u njoftova sot se kjo ndërmarrje edhe në Trustin Pensional nuk ka paguar asnjë cent për ta, ose të dhëna krejt simbolike nga 5-6-7-8 euro, çka flet se ata 22 paga i kanë mungesë. Do të ishte shumë mirë që kësaj t'i kushtojmë vëmendje të veçantë. E mbështes idenë e koleges Besa, që nga kjo asamble të zgjidhet një komision për verifikimin e saktësisë së kësaj letre dhe të ju jepet një përgjigje.

Në rast se nuk e bënë ky komision, ne si Vetëvendosje detyrohemi ta bëjmë vet, pastaj mos na akuzoni për politizim të situatës.

Kryesuesi tha se ky Kuvend nuk do të bëjë komision mbi komision. Letra është anonime, me letër publike i drejtohet dikujt dhe ia shkruan emrin, letra është publike por është anonime.

Kimet Zeqa paraqiti disa vërejtje lidhur me zbatimin e rregullores në praktikë. P.sh. polici që hynë në autobus, ai mund të zbresë ku të doje, edhe pse e pengon komunikacionin, pra a kanë të drejtë ta pengojnë në atë mënyrë komunikacionin. Gjithashtu edhe vendosja e fotografive nuk do duhej të bëhej nëpër autobusë, andaj kërkoj që të zbatohet në përpikëri neni 31 i kësaj rregulloreje.

Naim Makolli u pajtua me propozimin e znj. Besa, që e dha për letrën anonime. Për të gjitha këto shqetësimet që i kanë ngritur në këtë letër, unë kisha propozuar që, në mbledhjen e ardhshme, drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, z. Agim Gashi, pikë për pikë të na raportojë dhe të shohim se cilat janë të vërtetat, e cilat janë të pavërtetat e kësaj letre.

Shemsi Veseli tha se në parim po pajtohem të gjithë dhe nuk mundem të jemi indiferent për të dhënat që shkruhen këtu. Do të duhej të merrnim një qëndrim, që komisionarët, aksionarët tanë që janë aty, ta përgatisim një informatë për mbledhjen e ardhshme, që t'i verifikojnë disa gjëra konkrete, sepse këtu në brendësi të kësaj kemi të bëjmë me një donacion që e kemi votuar për 50 000 €.

Agim Gashi tha se minimumi i largësive të vend-ndaljeve të autobusëve është një çështje e rregulluar me Rregulloren e linjave, sipas së cilës minimumi është prej 300-500 metra largësi, varësisht nga nevojat urbanistike.

Sa i përket kësaj që po e kërkon nga unë, unë nuk mundem ta zëvendësoj as Bordin as Komisionin e aksionarëve. Një gjë që është përmendur aty një emër, si mbrojtës i keqbërësve, Agim Gashi nuk e ka futur askënd nën ombrellë, dhe kur të dojë le t'i hyjë kësaj pune hetuesia.

Njëzëri u miratua Rregullorja për transportin rrugor në territorin e komunës së Prishtinës.

Pika e shtatë

Lidhur me Propozimrregulloren për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Prishtinës, Agim Salihu tha se Kryetari i Komunës ka nxjerrë Vendimin për kushtet dhe kriteret e ndarjes së subvencioneve. Në këtë vendim është paraparë që në fushën e arsimit, përveç fushave që kanë të bëjnë me ekonomi, shëndetësi, kulturë rini dhe sport, të jetë edhe fusha e arsimit në të cilën fushë Komuna ka mundësi të ndarjes së bursave për studentë.

Flamur Shala, në emër të GP i LDK-së, tha se Komuna e Prishtinës po vazhdon kujdesin e saj për qytetarët e saj në përgjithësi, dhe për të rinjtë në veçanti.

Jo pak studentë të regjistruar, për shkak të gjendjes jo të mirë ekonomike, me vështirësi financiare i përballojnë studimet.

Me këtë projektregullore, pra me këtë propozim, po fillon një fazë e re e përkrahjes dhe e përkujdesjes së mundshme për të gjithë ata studentë të dalluar të universiteteve publike në Kosovë që janë nga Prishtina.

Studentëve me rezultate dhe suksese në studime do t'iu ofrohet përkrahja financiare me bursat që do t'i ndaj Komuna e Prishtinës, gjithsesi duke iu dhënë përparësi studentëve të familjeve të dëshmorëve, të viktimave civile të luftës, të invalidëve dhe veteranëve të luftës, studentëve me aftësi të kufizuara dhe veçanërisht atyre dy e më shumë studentëve që janë nga e njëjta familje.

Grupi i LDK-së do të votojë për miratim të këtij propozimi të Rregullores për ndarjen e bursës për studentë të komunës së Prishtinës.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se këtë rregullore e kemi përkrahur të gjithë në Komitetin për Politikë dhe Financa. Vërehet se vërejtjet të cilat i kemi dhënë në përgjithësi janë pranuar. E diskutuam çështjen e studentëve që kanë notën mesatare mbi 9, se ata marrin bursë prej universitetit, kështu që unë kisha kërkuar që t'i kursejmë ata, se ata do të konkurrojnë prapë edhe do të ankohen se pse nuk iu është ndarë bursa.

Besa Halimi-Zagragja tha se nëse të gjithë bursistët e universitetit, d.m.th. të gjithë ata të cilët arrijnë notën mesatare adekuate për të marrë bursë universiteti janë të përfshirë në bursa, atëherë ata automatikisht me nenin tjetër përkatës anulohen nga e drejta e aplikimit në këtë bursë. Por, në fakt, çfarë kuptimi ka pastaj përshkrimi i këtyre notave, i këtyre arritjeve për marrjen e bursave nëse ata janë bursistë të universitetit, d.m.th. ose është një anomali që duhet të eliminohet, të mos figurojë fare suksesi, ose të përcaktohet që ata të cilët arrijnë sukses e nuk marrin bursë të universitetit, të kenë të drejtën dhe përparësinë siç është paraparë këtu.

Unë desha të them edhe diçka tjetër lidhur me Rregulloren e bursave, neni 9 do duhej të ndahej në dy pjesë, për shkak të trajtimit të suksesit, dhe pjesa tjetër përcakton kriteret tjera që lidhen me gjendjen sociale, me trashëgiminë e familjarëve të përkatësisë të veteranëve të luftës, e kështu me radhë.

Në nenin 10, propozoj që fjala "familje" do duhej të përcaktohet më saktë.

Meliza Haradinaj tha se GP i AAK-së e përshëndet propozimin për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Prishtinës. Edhe pse e konsideron si vendim tepër të vonshëm, prapë se prapë është pozitive edhe e dobishme për shoqërinë kosovare në përgjithësi.

Ne i kemi edhe disa sugjerime shtesë, duke filluar prej nenit 3, pika 2, ku përcaktohet: ku studentët do të kenë të drejtë, do të thotë përparësitë që studiojnë në lëmenjtë deficitare, do të duhej të jetë një definim i saktë se cilët janë lëmenjtë deficitare në mënyrë të specifikuar. Varësisht nga këto prioritete, do duhej t'i jepen bursat fakulteteve përkatëse të universitetit publik. Konsideroj se pa bërë ndonjë studim ose hulumtim për këtë çështje, Komuna nuk do të mund të fokusohet dhe të ndihmojë me bursa në shëndetësi, zhvillim ekonomik lokal, arsim apo lëmenj të tjerë.

Sa i përket nenit 8, pika q, për realizimin e të drejtës në bursë, tha se rreth kësaj pike duhet të kemi kujdes se si të veprojmë.

Te neni 10, ku përcaktohen kushtet dhe kriteret, propozoj që të ndahen ose të definohen më saktë ose të inkorporohen të gjitha tek neni 8 ose 9, duke specifikuar se me sa pikë vlerësohet secila kategori, në mënyrë që t'i evitojmë keqpërdorimet. Tek neni 14, propozoj që të futet një paragraf, i cili e obligon kushtimisht studentin që të

kontribujë pas diplomimit në fushën ose lëmin përkatëse për të cilën e fiton bursën. Te neni 15, propozoj që të jetë: “mjetet financiare do duhej të derdhen direkt në xhirollogarinë e universitetit”.

Shefki Gashi tha se kjo rregullore është dashtë që të parasheh edhe ndarjen e bursave për universitetet private. Duke pasur parasysh se një numër i madh i studentëve nuk po mundën të regjistrohen në universitetet publike, unë konsideroj se ky është një diskriminim i madh për ta.

Propozoj që studentja e cila nuk ka prindër, të vlerësohet me më shumë pikë. Gjithashtu edhe te studentët me aftësi të kufizuara, unë kisha dashur që të ketë më shumë se sa vetëm 10 pikë, bile te ta mos të vlejë nota mesatare, sepse besoj që Komuna e Prishtinës ka mjete për ta mbuluar numrin e studentëve që i ka këtu përafërsisht këtyre me notë të mirë. Këtë propozimrregullore e përkrahim për miratim.

Feti Mehdiu tha se kjo rregullore është mjaft complete, por megjithatë kemi disa sugjerime. Nenin 3 e kemi shikuar, situata kur ka lindur në Prishtinë i eliminon njerëzit, të cilët në rrethana të ndryshme nuk kanë mundur të lindin në Prishtinë, andaj mendojmë se nuk do të ishte mirë të figurojë kjo, i lindur në Prishtinë.

Vërejtje për nenin 15, mendojmë se këtu duhet të jetë se bursa duhet të jepet për çdo muaj. Për nenin 8 tha se do të ishte mirë që ky nen të parasheh se bursa mund t'i jepet edhe atij që është fillestar, por në bazë të suksesit të shkollës së mesme. Këtë rregullore e përkrahim, por do të ishte mirë që të ketë një stimulim për kuadër deficitarë. Edhe për ata që i kanë mundësitë e kufizuara, janë paraparë familjet etj.

Afërdita Veliu tha se e kemi shqyrtuar këtë rregullore dhe kemi disa vërejtje dhe propozime. Te neni 3, edhe ne mendojmë se nuk do të duhej të figurojë “të lindur”, por vetëm banorë të Prishtinës. Gjithashtu në këtë nen ceket se studentët në studime pasuniversitare, master dhe doktoratë, përjashtohen nga kjo rregullore. Përderisa përjashtohet ky grup, a do të trajtohet dhe a e ka ndërmend Komuna të ndërmarrë ose të krijojë ndonjë fond të veçantë për këtë kategori të studentëve.

Për nenin 4, pyes se pse nuk i lihet në kompetencë Kuvendit që të marrë vendim për numrin e bursave, por i lihet në kompetencë të Kryetarit të Komunës. Vërejtje për nenin 9, rreth kritereve, mendojmë se studentët të cilët vijnë nga familjet e pasura dhe që kanë një mirëqenie, do të duhej të përjashtohen nga kjo mundësi, në mënyrë që t'iu jepet mundësia rasteve sociale dhe rasteve të tjera që kanë më shumë nevojë për këtë bursë. Tek pika g, studentët të cilët nuk kanë prindër, propozoj që të vlerësohen me 30 pikë. Gjithashtu pika h, studentët me aftësi të kufizuara, mendojmë se duhet të vlerësohen me 20 pikë.

Shemsi Veseli fillimisht tha se do të ishte mirë që të bëjmë një ndarje, le të jetë numri, nuk është me rëndësi se sa të jetë, por që këto kategori d.m.th. ta kenë të veçantë çështjen e konkurrimit për këto burse.

Mendoj që nenin 10, ndoshta kishte me qenë mirë te kushtet dhe kriteret e njëjta, vërtet këtu precizohet që kanë përparësi, e kemi që po precizohet që kanë përparësi. Por, nuk po e di se a do të jetë mirë niveli jonë, kur dikush i bënë me i shti krejt në një vend, ndoshta veçimi i tyre do ta lehtësonte punën që me u bërë një përzgjedhje edhe më e mirë edhe për këto kategori tjera të atyre studentëve ose fëmijët se nuk i takojnë atyre familjeve.

Të jemi shumë të sqjertë, kur vjen familje e dëshmorëve p.sh. e sheh fëmijën e një dëshmori e të hyjë dhe të konkurrojë dhe të ketë kritere të njëjta.

Megjithatë, ndoshta është mirë që me e bërë një përzgjedhje më të mirë, duke shtuar në neni 10 ose me e bërë një nen të ri, po mendoj vetëm si propozim po e jap, për arsye se po e shoh paskan vepruar komunat tjera dhe tash, meqë ne jemi kryeqendër e Kosovës, edhe për me qenë udhërrëfyes thjesht për komuna tjera ndoshta që me reflektuar.

Sadri Ramabaja tha se i përshëndes autorët e hartimit të kësaj rregulloreje, por po përpiqem t'i kuptoj edhe në gjendjen në të cilën kanë qenë pse janë detyruar të hartojnë rregulloren. Arsyeja sepse nuk jemi shtet normal, po të ishim shtet normal, nuk do të kishim nevojë për një rregullore të kësaj natyre, sepse këto do të duhej të mbuloheshin me ligj. Në nivel evropian janë të precizuara qartë, është e precizuar qartë e drejta e shkollimit, e drejtë si e drejtë elementare. Ndërkaq ata që kanë mundësi, qoftë në universitete private, qoftë diku tjetër, ai nuk ka nevojë për të kërkuar te ne bursë. Në rast se do të bëhet diferencim, atëherë praktikisht do të ju shkelet e drejta elementare e tyre për shkollim. Pse po insistoj këtu, sepse ne jemi dëshmitarë që edhe te ndarja e banesave, edhe te disa tjera, kanë marrë ata që i kanë shtëpitë nga tri kate. Çështja këtu është për kategoritë që nuk kanë mundësi, kanë vullnet, natyrisht kanë edhe dije dhe dëshmojnë me nivelin e notave etj. Ndërkaq sa i përket çështjes së familjeve të dëshmorëve e tjerë, është një çështje tjetër, që nuk do të duhej të futej këtu në këto rregullore. Po mendoj se do të ishte mirë që, para se të miratohej, në parim ne mund ta miratojmë edhe sot, po të merren parasysh këto vërejtje dhe modelet se si trajtohen këto çështje në nivelet përparimtare evropiane.

Ajnishahe Azemi tha se me këtë rregullore, pra, te neni 9, mendoj se te pika "h" duhet të shtohet jo në 10 pikë, por në 30 pikë, dhe në anën tjetër te neni 10, të shtohet po ashtu përparësi kanë studentja apo studenti me aftësi të kufizua, nëse janë kushte dhe kriteret, në kushte të barabarta. Këtë e them duke u bazuar në atë se këta studentë apo studente, me aftësi të kufizuara, kanë nevoja shtesë nga studentët tjerë për me mundur për me i vazhduar studimet.

Tefik Mehmeti th a se te neni 10, ndoshta ka mundur të vlerësohet me pikë ai kriter, ndoshta neni 10 mos ka mundur me u vlerësuar me 5 pikë, p.sh. nëse veç pajtohemi, Komuna e Prishtinës do të japë bursa për të gjithë banorët e saj, çka shihet nevoja, për studimet deficitare, jo në atë kuptimin çka i nevojiten Komunës me punuar. Është e pamundshme me u paguar muaj për muaj, sepse i dimë ne procedurat, financat, që është një procedurë shumë e komplikuar për çdo muaj me ia përcjellë. Por ato janë çështje që i rregullon Kryetari me vendime të ndryshme.

Halim Halimi tha se ajo që po theksohet që të përfshihen të gjithë me gjendje të rëndë sociale, ajo nuk mund të bëhet, dhe ndarja për çdo muaj, edhe ajo është e pamundur. Ma merr mendja se shuma, lartësia e bursës nuk do të jetë mbi 50-60 euro

Kryesuesi tha se në nenin 3 do të hyjë propozimi që njëri prej kritereve që e dokumenton si banor të Prishtinës, të jetë "10 vitet e fundit banor i Prishtinës".

Me dy abstenime, (Sadri Ramabaj dhe Aferdita Veliu) , u miratua rregullorja për ndarjen e bursave për student të Komunës së Prishtinës.

Pika e tetë dhe e nëntë

Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme

Kryesuesi

Para se të fillonin me pikën “Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme”, kryesuesi i njoftoi të pranishmit për shqetësimin e shfaqur nga z. Borovci në Komitetin për Politikë dhe Financa, që ka të bëjë me problemin e 52 pronarëve të shtëpive pranë shkollës “Iliria”, në luginën “Kodra e Diellit”. Kjo çështje ka të bëjë me një procedurë, e cila është zhvilluar në vitet e 80-ta, një ekspropriim për zhvillime, që është marrë atëherë nga drejtorja, gjegjësisht nga Sekretariati. Realisht, janë hequr nga prona në kuptimin formalo – juridik, por kurrë nuk janë shpronësuar dhe ata janë pronarë faktik. Për këtë çështje jemi konsultuar me Kryetarin, me Zyrën ligjore, me Agjencinë Kadastrale, me juristë dhe do të mundohemi të bëjmë një përkufizim, ta kthejmë në Kuvend dhe kjo çështje të zgjidhet me procedurë të Kuvendit, sepse një vendim tashmë nuk mund të revokohet, pasi që procedurat administrative janë kryer më herët.

Mejreme Berisha ngriti shqetësimin që kishte të bënte me mosfunksionimin e transportit publik në fshatin Koliq. Këtë problem e shtroi në emër të banorëve të këtij fshati, duke cekur se me një kërkese të tillë është njoftuar edhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Janë 135 nënshkrime të banorëve të Koliqit, të verifikuara me leje të njoftimit, të cilët kërkojnë që drejtorja t’ua mundësojë një transport publik për këta qytetarë, të cilëve iu është vështirësuar jeta. Një numër i madh i nxënësve të shkollave të mesme dhe punëtorëve nuk kanë mundësi qarkullimi. Në shenjë pakënaqësie, banorët kanë nënshkruar këtë peticion, me qëllim që organet komunale të ndërmarrin masa serioze në zgjidhjen e këtij problemi. Kjo gjendje po ndikon në boshatisjen e fshatit, pra është i vetmi fshat që nuk ka transport.

Në fakt, është një kombibus që i dërgon mësuesit në orën tetë dhe kthehet në orën një me mësues, jo me banorë të fshatit, andaj e besoj se si Komunë do t’iu dalim në ndihmë këtyre njerëzve.

Kryesuesi tha se këtë çështje e keni ngritur edhe herëve të tjera, por në mungesë të banorëve asnjë operator nuk pretendon që ta mbajë atë linjë, pasi që janë linja jo profitabile.

Naime Osmani, pyetje për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale

Me inaugurimin e objektit të Mjekësisë Familjare në Besi, çfarë do të bëhet me objektin e vjetër, a do të mund të shfrytëzohet për çerdhe të fëmijëve?

Pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Kërkoj nga kjo drejtori, vetë drejtori apo persona kompetent, të dalin në terren përgjatë rrugës Besi– Rimanishtë, të shohin gjendjen alarmante që është krijuar nga hedhja e mbeturinave vend e pa vend nga persona të papërgjegjshëm. Pra, të verifikohet gjendja dhe të shihet mundësia se si mund të na ndihmoni për pastrimin e ambientit me mjete teknike. Po ashtu, të shihen mundësitë edhe për ndriçimin e rrugëve në fshatin Besi, në lagjen e parë dhe në lagjen e Bllacajve.

Pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale

Para dy muajve nga kjo drejtori është kërkuar që neve këshilltarëve të na dorëzohet lista e projekteve që do të realizohen brenda vitit 2013, por ajo nuk na është dorëzuar. Atëherë kërkoj që kjo t’u dorëzohet në mënyrë zyrtare kryetarëve të bashkësive lokale.

Tenderin e shpallur për rregullimin e rrjetit të kanalizimit për lagjen e parë të fshatit Prugovc e ka fituar një kompani, andaj me kërkesën e banorëve të fshatit Besi, respektivisht familjeve Mexhuani dhe Prebreza, ju drejtohem që të iu mundësohet kyçja në këtë rrjet, pasi që pozita gjeografike nuk iu ka mundësuar të lidhen në rrjetin e fshatit Besi.

Pasi është fjala tek rrjetet e kanalizimit, kërkoj që një ekip i ekspertëve nga ky drejtorat të dal edhe një herë në fshatin Besi, tek familja minoritare Marrolli (ashkali), që të shihni mundësinë se si të rregulloni apo ku mund të kyçen në rrjetin e kanalizimit po ashtu edhe në lagjen e Bllacajve, kur dhe si do të bëhet projekti për rregullimin e kanalizimit.

Shaip Hajrizi, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale

Në emër të qytetrëve pranë rrugës "Xhavit Berisha", që gjendet në lagjen "Kodra e Trimave", kërkoj nga Komuna e Prishtinës që ta rregullojnë këtë rrugë, e cila është shumë e dëmtuar dhe e pakalueshme. Kjo rrugë është e dëmtuar edhe më shumë me rastin e hapjeve të kanaleve nga ana e KEK-ut për vendosjen e kabllove të tensionit të lartë dhe të pusetave, për ta vazhduar rrjetin elektrik në Qendrën e Panairëve. Kjo rrugë është pronë publike dhe është shumë e vjetër. Qytetarët e kësaj rruge së paku tri herë i janë drejtuar Drejtorisë së Infrastrukturës për ta rregulluar.

Kërkesa tjetër i përket lagjes "Sheshi i Arbërit" te Bunari i Hajratit, ku përveç katër rrugëve që janë në gjendje të mjerë, të cilat bashkë me drejtorin e Drejtorisë së Financave dhe Pronës i kemi vizituar, atyre iu mungon uji, por edhe rryma është shumë e dobët. Banorët e asaj lagjeje kërkojnë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që me ndonjë marrëveshje me KEK-un të bëhet përforsimi i rrymës për atë pjesë.

Lidhur me çështjet e ngritura nga z. Hajrizi, **Kryesuesi** tha se ndërtimi i rrugës "Xhavit Berisha" është në kompetencë të ministrisë përkatëse.

Sa i përket këtyre katër rrugicave që kanë mbetur, kemi biseduar edhe me Kryetarin për mënyrat dhe format se si do t'i qasemi këtij problemi. Atje paraprakisht duhet të zgjidhen problemet pronëso- juridike, e më pas të fillohet në ndërtimin e tyre.

Çështjet e ujit dhe të KEK-ut janë çështje, të cilat asnjëra nuk janë në kompetencë të Komunës.

Afërdita Veliu, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale

Lidhur me pyetjen e parashtruar, ngriti një shqetësim të një grupi të qytetarëve të fshatit Bardhosh, të cilët para disa ditësh ishin në qendrën e Lëvizjes Vetëvendosje dhe na treguan për shqetësimin që kanë për punimin e disa trotuareve në fshatin Bardhosh.

Ata qytetarë sollën edhe disa foto të këtyre trotuareve, ku shihet qartë se këto punime janë kryer shkel e shko, të cilat në radhë të parë rrezikojnë jetën e qytetarit, sepse niveli i trotuareve, krahasuar me rrugën, është jashtëzakonisht i ulët, d.m.th. veturat lirisht mund të lëvizin edhe nëpër trotuare, të rrezikojnë jetën e qytetarëve, veçanërisht të fëmijëve.

Unë sot do të bëja pyetje për drejtorinë përkatëse: Çfarë është duke bërë Drejtoria e Infrastrukturës Lokale lidhur me pranimin teknik të këtyre rrugëve, sepse pranimi teknik nuk do duhej të bëhej në një gjendje të këtillë, dhe a po kërkohet përgjegjësi nga këto firma të papërgjegjshme? Firmat e tilla nuk do duhej të lejoheshin të bëjnë punë të tilla dhe do duhej të eliminoheshin, mirëpo një gjë e tillë po shihet se nuk është duke u bërë. Unë do doja shumë që të merrja një përgjigje nga drejtoria përkatëse, normalisht më shumë se përgjigjen, do doja të shihja një punë konkrete që

do ta bënte kjo drejtori për hir të qytetarëve, për hir të ruajtjes së shëndetit dhe jetës së qytetarëve.

Lidhur me shqetësimin e ngritur nga znj. Veliu, kryesuesi tha se kjo rrugë nuk është në fshatin Bardhosh, por është në dalje të qytetit dhe lidhet me rrugën "Vëllezërit Fazliu", pra nuk ka të bëjë me rrugën e fshatit.

Sadri Ramabaja paraqiti një shqetësim të banorëve të Bashkësisë lokale të Arbërisë. Kjo Bashkësi ka dërguar dy letra në adresën e drejtorit të Administratës dhe Personelit të Komunës së Prishtinës, njëherë më 21 shkurt 2013 dhe tjetër më 11 mars 2013, ku kanë ngritur një çështje që ka të bëjë me objektin e Bashkësisë lokale, që aktualisht shfrytëzohet nga Shoqëria Kulturo-Artistike "Gerçek". Ata nuk kanë mundësi të zhvillojnë aktivitetin e tyre atje, pra janë përjashtuar nga mundësitë reale që do të duhej ta kishin si Bashkësi lokale, ndërkaq SHKA "Gerçek" sillet madje edhe shumë ashpër me anëtarët e Bashkësisë lokale.

Do të ishte mirë që në shkresat e drejtuara të ktheni përgjigje, aq më tepër kur kemi të bëjmë me instanca të pushtetit lokal, në rastin konkret shkresa është drejtuar nga kryetari i Bashkësisë lokale.

Kërkoj të na jepni përgjigje me shkrim rreth çështjes së ngritur.

Naim Makolli tha se kohëve të fundit ka filluar ndryshimi i rrugëve përkatëse, p.sh. tash rruga "Tutini" ka një emër tjetër, dhe nuk e dimë a është ndonjë gabim i asaj kompanie që po e bënë vendosjen e tabelave të rrugëve, apo çka është në pyetje, ndërsa në largësinë prej 100 m më tutje në atë rrugë, është vendosur emri "Qëndresa", dhe gjysma tjetër e ka emrin "Martirët e ..." (për momentin nuk e kam emrin e qartë), por në atë rrugë janë vendosur dy emra edhe është hequr emri paraprak që ka qenë i vendosur pas luftës. Desha të dije se a është gabim i kompanisë vendosja e këtyre emrave të rinj të rrugës ekzistuese, apo çka është problemi.

Një problem tjetër është edhe vendosja e familjes së Nebi Ramës nga Keqekolla në ish-kazermën e Llukarit. Do të doja të kisha informacione se a e ka vizituar dikush atë familje dhe cili është problemi që rrinë atje, ajo është një familje me gjashtë anëtarë, dhe a paraqet ndonjë rrezik qëndrimi saj në atë vend, kur e dihet se ajo kazermë gjatë luftës është bombarduar.

Dua ta shtroj edhe një pyetje tjetër për të njëjtën drejtori, për banesat që i kemi dhënë për rastet në asistencë sociale. Sipas informacioneve që kam, ka ende banesa që janë të pa shfrytëzuara nga pronarët. Nëse ka me të vërtet banesa të lira aty që akoma nuk shfrytëzohen, a do të duhej që prapë komisioni të verifikojë që ajo familje ka apo jo nevojë për banesë.

Një tjetër çështje për rrugën "Vëllezërit Fazliu", te hyrja për shkollën "Hilmi Rakovica". Aty janë vendosur gjysmë sferat për ndalimin e qarkullimit të shpejtë të automjeteve, mirëpo për shkak të uljes tepër të madhe që ka trotuari, automjetet lëvizin edhe nëpër trotuare. Në këtë rrugë frekuentojnë një numër shumë i madh i nxënësve, andaj propozoj që aty të ngrihet trotuari, ose gjysmë sferat që janë vendosur në rrugë të vazhdojnë edhe në pjesën e trotuarit, në mënyrë që automjetet me shpejtësi të madhe mos të kenë mundësi manipulimi dhe lëvizje në trotuar.

Shemsi Veseli tha se për hirë të korrektësisë dhe për shkak të çështjes zyrtare, do të doja që përgjigja për çështjen e parcelës për ndërtimin e objektit të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë, të më jepet me shkrim, për arsye se nesër, si doktor që jam edhe i takoj QKUK-së dhe Fakultetit të Mjekësisë, ta kem edhe një arsyetim që e kam

ngritur si çështje. Megjithatë, uroj që sa më shpejtë, nëse mund të bëhet ndonjë zgjidhje më e mirë që do të jetë në aspektin e zgjidhjes së këtij problemi.

Çështja e dytë, që solidarizohem me çështjen e ngritur nga z. Borovci, dhe do të ishte e tepërt që Komuna t'i zvarrisë këto gjëra, kur ka të drejtë, në aspektin administrativ, ta bëjë zgjidhjen e këtyre problemeve, në mënyrë që të mos i pengojë këto familje që kanë të drejtë ta bëjnë zgjidhjen e tyre.

Kryesuesi tha se çështjen e ndërtimit të objektit të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë e kemi diskutuar, dhe askush nuk është që të mos ndërtohet një objekt arsimor, siç është ky dekanat, por problemi është që prona ku kërkohet është pronë komunale, dhe rektori me kryetarin kanë biseduar që mundësisht të gjindet pronë që është pronësi të Universitetit ose të QKUK-së, për të mos hyrë në procedura të këmbimit apo të ndërrimit, sepse ligji më nuk na lejon me nda, dhe këto janë çështjet të cilat duhet ata t'i rregullojnë.

Hetem Kupina tha se në mbledhjen e fundit, në emër të qytetarëve të fshatrave verilindore të Prishtinës, pata kërkuar nga drejtori i Shërbimeve Publike që të më jepet përgjigje me shkrim në pyetjen: Cila është strategjia dhe planveprimi i juaj për t'ju mundësuar qytetarëve të asaj ane që të bëjnë grumbullimin e mbeturinave, nga të cilat janë kapluar thuajse të gjitha fshatrat? E kërkova përgjigjen me shkrim, me arsyetimin që qytetarët të njoftohen jo nga unë, por nga vetë organi kompetent. Meqë nuk e kam marr përgjigjen, po e lus drejtorin të ma kthej përgjigjen në mbledhjen e ardhshme, në mënyrë që t'i njoftoj qytetarët.

Sadri Ramabaja tha se për hir të korrektësisë, dua ta mbështesë publikisht kërkesën e banorëve të Koliqit, të cilën e solli znj. Berisha, dhe jo njëherë, por sa herë ka bërë kërkesa të kësaj natyre, drejtorja përkatëse do të duhej t'ju përgjigjej pozitivisht atyre banorëve.

Kryesuesi tha se Kuvendi i Komunës nuk mundet të bëjë përzgjedhjen e kompanive për atë linjë, pasi që nuk ka udhëtarë.

Agim Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, lidhur me transportin e vijave rurale jorentabile, tha se Komuna deri më sot nuk ka subvencionuar këto relacione. Tash për tash drejtorja nuk është kompetente të përzgjedhë kompanitë që do të operojnë në ato linja, sepse nuk ka të drejtë ligjore, ajo shkon përmes tenderit në procedura të veçanta.

Të gjithë e kemi informatën se shumica e fshatrave nuk kanë linja, i shfrytëzojnë këto linjat e kontraktuara nga Komuna për nevojat e shkollave etj.

Sa i përket mbeturinave në Rimanishtë, kudo mbeturinat, jo vetëm në Rimanishtë, por edhe në Mramor, në Bardhosh edhe gjithkund, ne e kemi instrumentin shtetëror nëpër fshatra Bashkësitë lokale, dhe ato nuk i kemi kot, ato duhet të organizohen, aty ku organizohen ne ju ndihmojmë si Drejtori e Shërbimeve Publike, por ne nuk e pengojmë se nuk kemi mekanizëm për pengim. Atë e bënë inspeksioni, e bënë policia, e bëjnë mekanizmat tjerë që i ndalojnë kundërvajtjet kudo qofshin.

Trafoja bashkëfinancohet mes KEK-ut, Komunës dhe komunitetit. Nëse kërkesën e miraton KEK-u për pjesën e vet financiare, besoj se edhe Komuna do të participojë, sepse ka të drejtë. Ne si Komunë kemi financuar për disa trafo në këtë proces.

Te shenjzimi i emrave, këtu e kemi miratuar listën e emrave dhe të rrugëve. Ne po përpiqemi 100% ta zbatojmë dhe nëse është bërë ndonjë gabim, po ashtu përmes Komisionit e rregullojmë. Tash jemi në fazën përfundimtare të shenjzimit dhe emërtimit të rrugëve dhe vendbanimeve.

Sa i përket trotuareve, nuk kemi të drejtë të vëmë pengesa në trotuare, askund në botë nuk ka pengesa në trotuare, sepse pengon lëvizjen e lirë me karrocë, çështje e sigurisë i takon policisë.

Lidhur me shqetësimet e ngritura nga z. Makolli për mos shfrytëzimin e banesave për rastet sociale nga pronarët që janë përfitues të tyre, **Valbon Krasniqi**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale, tha se së shpejti do të formohet një komision dhe do të bëjë verifikimin e të gjitha banesave se a janë duke u shfrytëzuar sipas kontratës që e kanë. Sa i përket rastit të vendosjes së një familjeje në ish-kazermën e Llukarit, tha se për këtë rast do të formohet një komision në kuadër të Sektorit të mirëqenies sociale dhe do ta vizitojë këtë familje.

Mbledhja mbaroi në orën 14:45.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Sami Hamiti, ecc. i dipl.